



KOMUNA E SHTIMES
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Nr.09/46

Datë: 26.06.2026

THIRRJA E DYTË PUBLIKE

**PËR MBËSHTETJE FINANCIARE – FINANCIM TË PROJEKTEVE DHE
PROGRAMEVE TË KLUBEVE TË SPORTIT TË CILAT KANË PËR QËLLIM
RRITJEN E CILËSISË DHE ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE SPORTIVE
PËRMES AKADEMIVE, LIGAVE LOKALE DHE REGJIONALE DHE
PLASMANIN NË GARA TË LIGAVE KOSOVARE.**

Në bazë të Rregullores MF-Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve (Rregullore MF-Nr. 04/2017), veçanërisht neneve 2, 4, 5, 10, 11, 12, 13 dhe 15, si dhe në përputhje me Ligjin Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin 01Nr.06/1636 e Komunës së Shtimes, si dhe akteve tjera përkatëse në fuqi;

1. Drejtoria për Kulturës, Rini dhe Sport (DKRS) e Komunës së Shtimes shpall thirrjen e dytë publike për klubet sportive të regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat veprojnë në Komunën e Shtimes, e që janë të fokusuara në fushën e Sportit.
2. Kjo thirrje publike ka për qëllim mbështetjen financiare të projekteve dhe programeve të OJQ-ve që kontribuojnë në zhvillimin dhe masivizimin e sportit në Komunën e Shtimes.
3. Në përputhje me këtë thirrje, OJQ-të mund të aplikojnë me projektet dhe programet e tyre të fokusuara në fushën e sportit dhe klubeve sportive, që synojnë rritjen e cilësisë dhe zhvillimin e kapaciteteve sportive përmes akademive, ligave lokale dhe regjionale dhe plasmanin në gara ta ligave kosovare.

- 
4. Procesi i ofrimit të mbështetjes financiare do të zhvillohet duke respektuar parimet e konkurrueshmërisë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, gjithëpërfshirjes gjinore, transparencës, efektivitetit dhe ekonomizimit në përdorimin e fondeve publike, llogaridhënies, parandalimit të konfliktit të interesit dhe dyshkallshmërisë në trajtimin e ankesave, në përputhje me nenin 4 të Rregullores MF-Nr. 04/2017.
 5. Përzgjedhja e përfituesve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë thirrje publike, përmes një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara me Rregulloren MF-Nr. 04/2017.
 1. Vlera e përgjithshme e financimit e planifikuar sipas kësaj thirrje publike është: tridhjetë mijë **(30,000.00) euro**.
 2. Vlera minimale e përkrahjes për një projekt është **5%**, ndërsa vlera maksimale e përkrahjes për një projekt është **80 %**.
 3. Afati për dorëzimin e propozimeve sipas kësaj thirrje është pesëmbëdhjetë (15) ditë pune, nga data 26.08.2026 deri më datën 12.09.2026, **në ora 16:00**.
 4. OJQ-të mund të aplikojnë me programe ose projekte në kuadër të kësaj thirrje, vetëm më një projekt apo program në fushën përkatëse të thirrjes.
 5. Periudha e zbatimit të projekteve sipas kësaj thirrje është deri në **dhjetor të vitit 2026**.

II. KRITERET PËR APLIKIM

1. Për t'u kualifikuar për mbështetje financiare publike sipas kësaj thirrje, aplikuesit duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara si në vijim:
 - 1.1. Të jenë të regjistruara si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës, dhe të cilat veprojnë në Komunën e Shtimes, së paku gjashtë (6) muaj para datës së publikimit të thirrjes publike;
 - 1.2. Të dëshmojnë se programi i tyre i punës është i fokusuar në fushat e përmendura sipas kësaj thirrje;
 - 1.3. Të kenë kryer të gjitha transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit për OJQ-të në Republikën e Kosovës dhe në përputhje

me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;

- 1.4. Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- 1.5. Të dëshmojnë se personi përgjegjës në OJQ dhe menaxheri i projektit nuk janë nën hetime për vepra penale;
- 1.6. Të kenë kryer të gjitha detyrimet tatimore ndaj ATK-së. Ndonëse mund të kenë detyrime të pashlyera në momentin e aplikimit, OJQ-ja që përfiton nga fondet publike para nënshkrimit të kontratës duhet të dëshmojë se ka kryer obligimet tatimore ose ka arritur marrëveshje me ATK-në për kryerjen e tyre në të ardhmen;
- 1.7. OJQ-të duhet të dorëzojnë një projekt propozim sipas formularit të aplikacionit të projektit/programit. Formulari F9 së bashku me formularin e propozim buxhetit sipas formularit F10;
- 1.8. OJQ-të të cilat nuk i kanë dorëzuar raportet financiare dhe narrative nga financimi i vitit 2025, nuk mund të aplikojnë.

III. Dokumentet kryesore të cilat kërkohen të dorëzohen nga OJQ-të përfshijnë:

1. Të gjithë aplikuesit duhet të dorëzojnë dokumentet kryesore, si në vijim:
 - 1.1. Certifikata e regjistrimit të OJQ-së (Obligative);
 - 1.2. Certifikatën e numrit fiskal (Obligative);
 - 1.3. Vërtetim mbi kryerjen e të gjitha detyrimeve tatimore, i cili duhet të dorëzohet komisionit vlerësues para publikimit të rezultateve përfundimtare (pas publikimit të rezultateve preliminare të përfituesve) (Obligative);
 - 1.4. Të ketë dorëzuar projekt propozimin të plotësuar në formatin e aplikacionit sipas kërkesave të thirrjes publike (Obligative);
 - 1.5. Të ketë dorëzuar propozimin e buxhetit në formatin sipas kërkesave të thirrjes dhe të plotësuar në tërësi (Obligative);
 - 1.6. Deklaratë e nënshkruar se për të njëjtin projekt nuk është pranuar financim i dyfishtë nga burimet tjera (Obligative);
 - 1.7. Një deklaratë me të cilën tregojnë se i kanë përmbushur detyrimet nga

mbështetjet financiare publike të mëhershme;

1.8 Të dorëzoj deklaratat e partneritetit në rastet kur propozohet implementimi i projekteve në partneritet;

1.9 Të dorëzoj CV të menaxherit të projektit

2. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë, të cilët së bashku me udhëzimet për aplikantë janë në dispozicion në ueb faqen e internetit të Komunës së Shtimes.
3. Dokumentet e kompletuara duhet të dërgohen me postë ose personalisht, në adresën: Rruga "Tahir Sinani" Nr.50, 72000 Shtime, Republika e Kosovës / Komuna Shtime /Zyra e Sportelit.
4. Procesi i pranimi, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumenteve dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes janë të detajuara në udhëzimet për aplikuesit e thirrjes publike.
5. Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara të thirrjes publike.
6. Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen në zyrat e DKRS.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

